



UNIVERSITETI I TIRANES  
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE





FILLIMI RRETH FAKULTETIT » DEPARTAMENTET » STUDENTET » KERKIMI DHE BOTIME » NJOFTIME DHE NGJARJE GALERIA KONTAKT

## PROJEKTI ERASMUS+ MUNDUS – ELA

by Shkenca Sociale

Comments are off

RRETH PROJEKTIT	PARTNERËT E PROJEKTIT	EKIPI I PROJEKTIT I FSHS	VEPRIMTARI NDËRKOMBËTARE	
VEPRIMTARI LOKALE	PUBLIKIME	MATERIALE MËSIMORE	FOTO DHE VIDEO GALERI	KONTAKT

### Veprimtari të vitit 2018

#### Prezantim i projektit ELA në Ditën e Evropës, 9 maj 2018

Më 9 maj 2018, Dita e Evropës, ekipet e Universitetit të Tiranës dhe të Universitetit të Durrësit morën pjesë në aktivitetet e organizuara nga Delegacioni i BE në Fshatin e BE-së (sheshi Skënderbej) në Tiranë. Në këndin *Kulturë dhe Edukim*, Zyra Kombëtare Erasmus + Shqipëri ekspozoi materiale nga projektet Erasmus + Mundus. Dy postera dhe një fletëpalosje e projektit ELA u ekspozuan në Ekspozitën e Posterave të Projekteve. Ekipet e Universitetit të Tiranës dhe të Universitetit të Durrësit shkëmbyen përvojën me ekipet e universiteteve të tjera të vendit që po zbatojnë Projektet Erasmus + Mundus. Më shumë informacion ju mund të merrni në lidhjet:

<https://www.facebook.com/Albanian-Erasmus-Office-359546980904543/>

<https://www.facebook.com/359546980904543/photos/pcb.1032475760278325/1032474216945146/?type=3&theater>



**Takim i ekipit të punës të projektit, UT, Tiranë (Shqipëri), 16 prill 2018**

Më 16 prill 2018, ekipi i Universitetit të Tiranës zhvilloi një takim me fokus në detyrat për tre

aktivitetet e ardhshme ndërkombëtare që do të organizohen në Minsk, Bialystok dhe Moskë në periudhën qershor-korrik 2018. Ekipi diskutoi mbi draftin e tre programeve të përditësuara të lëndëve që lidhen me legjisllacionin në arsim që ofrohen në tre programe master; diskutoi për mundësinë që modulet EduLaw të ofrohen si një kurs i shkurtër trajnimi për drejtorët dhe mësuesit e shkollave në kuadrin e zhvillimit të tyre profesional; diskutoi për mundësinë e ofrimit të paketave të moduleve si një mësim i përzier, ku mësimi zhvillohet ballë për ballë dhe me teknologji mësimore bashkëkohore. Tema e dytë e diskutimit ishte përgatitja e kumtimeve që do të prezantohen në konferencën e ATEE në Bialystok. Ekipi i Universitetit të Tiranës mori përgjegjësinë për të paraqitur dy kumtesa. Tema e tretë e diskutimit u përqendrua në kandidatët dhe projektet e mundshme kërkimore që mund të paraqiten në shkollën verore ndërkombëtare që do të organizohet në Moskë.



**Takim i ekipit të punës të projektit, UT, Tiranë (Shqipëri), 12 mars 2018**

Më 12 mars 2018, ekipi i moduleve të projektit të Universitetit të Tiranës pati një takim rreth versionit përfundimtar të tekstit të videos, prezantimit me power point të dy moduleve: "Legjisllacioni për cilësinë në arsim" dhe "Korniza Evropiane e Kualifikimeve (EQF) dhe zbatimi i saj". Ekspertët diskutuan për kriteret e përzgjedhjes së tekstit dhe mënyrën e prezantimit të rasteve.



**Takim i ekipit të punës të projektit, UT, Tiranë (Shqipëri), 19 shkurt 2018**

Më 19 shkurt 2018 ekipi i punës i projektit të Universitetit të Tiranës organizoi një takim mbi versionin përfundimtar të dy moduleve “Legjislatiioni për cilësinë në arsim” dhe “Korniza Evropiane e Kualifikimeve (EQF) dhe zbatimi i saj” dhe përmirësimet përfundimtare të bazuara në kontributin nga partnerët.

